

Data 12/11/2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Ndërhyrje për Përditësimin e Sistemit Kombëtar të të Dhënave Gjeohapësinore për Mbështetjen e Zhvillimit Rajonal: Fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë, Prodhimi i Imazheve ajrore të orientuara nadir dhe oblik, Skanimin LIDAR; DTM; trueOrtofoto, ortofoto.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79961200-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 259,571,896.57 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankes së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në 2,676,826.81 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur të kontrates në procedurën e prokurimit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore bazohet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është kërkuar duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shumën e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 40% e vlerës së përllëgëritur të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë

përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit që do të thotë që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e larte monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin, vlerën e kontratës dhe kohezgjatjen.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Kompania/operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Licence/Çertifikate profesionale për realizimin e punimeve, fotogrametrike, gjeodezike Kategoria NS 18, pika (e), ose ekuivalente, në përputhje me legjislacionin e vendit të origjinës.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore në fuqi ku përcakton se realizimi i punimeve të përcaktuara në terma të referencës kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse.

2.3.3 Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas TR/specifikimeve teknike të shërbimit të kërkuar, operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar gjatë tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, stafin teknik përgjegjës si më poshtë:

a) 1 Ekspert drejtues/Team leader: - duhet të ketë një eksperiencë në zbatimin e projekteve me fushën e objektit të kësaj procedure, vërtetuar nëpërmjet CV dhe rekomandimeve.

Profili i kerkuar: Të jetë diplomuar në nivel “Master” në degën Gjeodezi/Fotogrametri ose ekuivalente, vërtetuar nëpërmjet diplomës përkatëse.

Arsyetimi: Projekti është kompleks dhe kërkon për menaxhim të të gjithë komponenteve të tij për realizimin në kohë dhe me cilësi të shërbimeve të kërkuara.

b) Ekspertët kryesorë: - Minimumi 2(dy) ekspertë me eksperiencë në zbatimin e projekteve me fushën e objektit të kësaj procedure, vërtetuar nëpërmjet CV dhe rekomandimeve.

Profili : Të jenë diplomuar në nivel “Master” në degën Gjeodezi/Fotogrametri ose ekuivalente, vërtetuar nëpërmjet diplomës përkatëse.

Arsyetimi: Duke qenë se pjesë e objektit të prokurimit është prodhimi i imazheve ajrore të orientuara nadir dhe oblik, Skanimin LIDAR; DTM; trueOrtofoto, ortofoto, kërkohej dy ekspert për të bërë të mundur : a) 1 ekspert të jetë përgjegjës për prodhimin dhe kontrollin e cilësive të imazheve ajrore të orientuara nadir dhe oblik, trueOrtofoto, ortofoto ; b) 1 ekspert për prodhimin dhe kontrollin e cilësive të Skanimin LIDAR dhe DTM. Për këtë qëllim të 2 ekspertëve duhet të kenë njohuri të thelluara në fushën e Gjeodezisë/ Fotogrametrisë, duke u mbështetur në përdorimin e teknologjive më të avancuara. Kontrollit të cilësive të produkteve të sipërmedura objekt i këtij prokurimi.

-Për vërtetimin e punësimit të stafit si më sipër, operatori duhet të paraqesë Deklaratat “Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi ardhurave nga punësimi” të deklaruara për periudhën tre muajorë të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

c) (dy) Pilot – Pilot të licensuar me CPL (Comercial Pilot Licences) ose ekuivalente, me eksperiencë në zbatimin e projekteve me fushën e objektit të kësaj procedure, vërtetuar nëpërmjet CV dhe rekomandimeve sipas kërkesave të Autoritetit të Avjacionit Civil.

-Për vërtetimin e punësimit të pilotëve, operatori duhet të paraqesë kontratë pune/shërbimi të vlefshme deri në përfundim të afatit të kontratës

Arsyetimi: Duke qenë se projekti është i një rëndësie të vecantë dhe përmban komponente të ndryshme të cilat patjetër kërkojnë një menaxhim profesional për realizimin me sukses të saj, kërkohej 2 (dy) pilot me Licencë me CPL ose ekuivalente. Pilotet do të jenë përgjegjës për realizimin e fotografimit ajror me Avion me metodat Nadir dhe Oblik si dhe skanimet LIDAR sipas kritereve të kërkuar në dokumentat e specifikimeve teknike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi i kriterit: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm teknik të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, termat e references dhe volumet e shërbimeve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punëve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontrate, duhet të ketë një numër mesatar të punësuarish gjatë tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, minimalisht 10 (dhjetë) persona. Përfshihet stafi mbeshtetës mirëmbajtjes të pajisjeve teknologjike (avion + kamerë + Skaner) si dhe specialiste të përpunimit të informacionit që do të prodhohet dhe menaxhohet (specialist Fotogrametrie, IT, Gjeodet etj.)

Kjo duhet të vërtetohet me dokumentet si më poshtë;

a) Vërtetim nga Organet Tatimore mbi numrin e punonjësve shoqëruar me Deklaratat “Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi ardhurave nga punësimi” të deklaruara për periudhën tre mujorë të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë punonjës të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllëguar duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të references, volumet dhe fazat e projektit, kualifikimi i punonjësve, grafiku i shërbimeve, zërat sipas përshkrimit të produkteve dhe orët e punës, sipas Kodit të Punës etj. Meqenëse zhvillimi, përmirësimi dhe mirëmbajtja i një sistemi për menaxhimin e dokumentave, ku kërkohet një përpunim i madh të dhënash dhe një siguri e lartë të informacionit si dhe kur kërkohet që koha e realizimit të kësaj kontrate të jetë gjatë gjykojmë se Operatori Ekonomik duhet të ketë një numër minimalisht 10 (dhjetë) punonjësish

2.3.5 Mjetet dhe pajisjet teknike

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike të kërkuara në seksionin 2.3 dhe 3.3 të Termave të References, në pronesi ose qira, si më poshtë:

- 1 një Avion i posaçëm për instalim të kamerës fotografim ajror dhe skanimit Lidar.
 - Ofertuesi duhet të ketë në dispozicion dhe 1 një avion të dytë për të siguruar realizimin me sukses të projektit në afatet e parashikuara.
 - 1 një Kamera dixhitale posaçme për fotografimin ajror me avjon për kapjen e fotografive Ajrore Nadir dhe Oblike.
 - 1 një Aparat skanimi të teknologjisë LiDAR i posaçem për skanim me avjon
- a) Për avionet në pronesi të regjistruar në regjistrin e aviacionit civil të Republikës së Shqipërisë duhet të paraqitet;- certifikatë regjistrimi, -certifikatën e vlefshmërisë ajrore, - licencë radioje (sipas legjislacionit Kodit në fuqi). Për avionet me qira duhet marrëveshja e qirase dhe dokumentet shoqëruese(sipas legjislacionit Kodit në fuqi).
- b) Për Avionët, të cilët nuk janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me dispozitat Kodit ajror duhet paraqesin dokumentacionin sipas vendit të origjinës.
- c) Si dëshmi për të vërtetuar disponimin në pronesi ose qira të pajisjeve teknike kamera dixhitale dhe aparat skanimi, duhen dokumente që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira (fatura etj.).

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/entë kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Kërkesa për disponimin e avionëve dhe pajisjeve të specializuara (kamera dixhitale ajrore dhe aparat skanimi LiDAR) është thelbësore për sigurimin e kapaciteteve teknike të nevojshme për realizimin me cilësi të lartë të fotografimit dhe skanimit ajror. Avionët e posaçëm garantojnë kryerjen e fluturimeve të sigurta dhe të qëndrueshme, ndërsa një avion rezervë siguron vazhdimësinë e punimeve brenda afateve. Kamera ajrore mundëson kapjen e imazheve Nadir dhe oblike për prodhimin e ortofotove , Truefotove dhe modeleve 3D CITY, ndërsa aparati LiDAR siguron matje të sakta të terrenit dhe sipërfaqes. Dokumentet e pronësisë ose qirasë kërkojnë për të verifikuar ligjshmërinë dhe aftësinë reale të operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës sipas standardeve teknike dhe legjislacionit në fuqi.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontratë të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës

2.3.6 Operatori ekonomik/kompania duhet të disponojë dhe paraqesë Certifikatën e vlefshme si më poshtë:

-ISO 900 I: 2015 - Sistemet e menaxhimit te cilesise, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-ISO 4500I:2018 - Sistemi i Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne pune, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-ISO 2700 I :2022 - Sistemi i Memaxhimit te Sigurise se Informacionit, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
-ISO 1400 I: 2015 - Sistemi i Menaxhimit Mjedisor, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare, etj ose ekuivalent mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë ose vendet e origjinës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44/4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, sigurinë e informacionit, sigurinë e mjedisit, shendetit ne pune.

Argumentimi: -Përmbushja e standartit ISO 900 I është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontrate. Ky lloj r;ertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në teresi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë

Argumentimi: -Përmbushja e standartit ISO 2700 I është thelbësor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit të shërbimeve që kategorizohen në kontrate. Ky lloj r;ertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombetare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: -Nepërmjet c;ertifikimit ISO 14001, Operatori Ekonomik siguron zbatimin e sigurisë së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve që kategorizohen në kontrate. Ky lloj c;ertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombetare të duhura për menaxhimin e sigurisë së mjedisit gjatë zbatimit të kontratës .

Argumentimi: Përmbushja e standardit ISO 4500 I, është thelbësor, siguron zbatimin e sigurisë së shëndetit në punë. Ky lloj c;ertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombetare të duhura për menaxhimin e sigurisë së shëndetit gjatë zbatimit të kontratës

Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim për periudhën e garancisë së shërbimit për një periudhë minimum 1 vit (Aneksi nr.1).

**Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*

Përpara se të shpall njoftimin e fituesit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

Arsyeja pse nuk është ndare në lote: Autoriteti kontraktor ka vendosur që procedura të zhvillohet pa ndarje në lote, nëpërmjet një kontrate unike, pasi objekti përfshin një paketë të plotë shërbimesh fotogrametike, të cilat realizohen në mënyrë të integruar dhe kërkojnë sinkronizim absolut në kohë, gjeometri dhe parametra radiometrikë në kapjen LiDAR. Këto shërbime përfshijnë: fotografim ajror digjital (nadir dhe oblik), skanim LiDAR, prodhim DTM, ortofoto dhe true ortofoto, si edhe ndërtim të modeleve 3D që sinkronizojnë njera-tjetren gjatë procesit të fotografimit të parashikuar dhe në grafikun e realizimit të shërbimit. Ndarja e procesit në lote do të kërkonte:-përsëritje të fluturimeve ajrore, -kalibrime të shumëfishta të pajisjeve, -kontrolle të ndara të cilësisë, - dhe harmonizim të komplikuar ndërmjet operatorëve të ndryshëm. Kjo do të sillte kosto shtesë të panevojshme, zgjatje të afateve të realizimit dhe fragmentim të përgjegjësisë për produktin final. Në një projekt kombëtar që kërkon uniformitet të plotë teknik dhe saktësi gjeohapësinore, zbatimimi nga një operator i vetëm është i domosdoshëm për të garantuar cilësi, efikasitet dhe koherencë teknike të produkteve përfundimtare

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë "oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto", ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

1. Çmimi

pikët 80

2.Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafi për punime specifike shitesë **pikët 20**

2.1 Skanimi LIDAR për sipërfaqe jo më pak se 680 km² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit [0-10 pikë]

2.2 Fotografiimi ajror dixhital trueOrtofoto, ortofoto për sipërfaqe jo më pak se 11,359 km² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit. [0-10 pikë]

Kriteri Çmimi

[80] pike

Argumentimi: Kriteri i cmimit me 80 pikë është i bazuar ne rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Kriteri Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafi për punime specifike shitesë [20] pike

2.1 Skanimi LIDAR për sipërfaqe jo më pak se 680 km² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit [0-10 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik per te vleresuar per kete kriter duhet të provoje se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar ne eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

Sipërfaqja minimale referente për përvojnë në skanimin LiDAR të jetë jo më pak se 680 km², e cila lidhet drejtpërdrejt me Zonën 1 të projektit (zonat urbane), ku parashikohen volumet më kritike të punës dhe kërkesat më të larta të densitetit të të dhënave dhe saktësisë. Vendosja e ketij pragu garanton që opertori ekonomik ka kapacitet real dhe të provuar për të realizuar skanime LiDAR me densitet të lartë dhe cilësi të lartë në mjedise urbane komplekse, duke siguruaar besueshmërinë teknike dhe reduktuar rrezikun e mospërmbushjes së standardeve teknike.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet dokumentacionit te kerkuar sipas pikes 2.3 Kapaciteti Teknik, dorezimit te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara.

2.2 Fotografimi ajror dixhital trueOrtofoto, ortofoto për sipërfaqe jo më pak se 11,359 km² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit. [0-10 pikë]

Argumentimi: Operatori Ekonomik per te vleresuar per kete kriter duhet të provoje se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar ne eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si me poshte:

Sipërfaqja minimale referente për përvojën në fotografimin ajror dixhital dhe prodhimin e trueortofotove dhe ortofotove të jetë jo më pak se 11,359 km², e cila i korrespondon Zonës 1 dhe Zonës 2 të projektit (zonat urbane dhe rurale). Ky prag vendoset si kriter për vlerësimin me qëllim të sigurohet që operatorët ekonomkë të kenë demonstrueshëm kapacitetet te provuar teknik dhe operacional për të realizuar projekte të përmasave dhe kompleksitetit të ngjashëm me këtë kontratë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet dokumentacionit te kerkuar sipas pikes 2.3 Kapaciteti Teknik, dorezimit te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e references jane hartuar sipas standardeve dhe ne perputhje me perckatimet ligjore ne fuqi dhe jane pjese e pandare e DST